

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

Nr. i fletëve
Broj stranica
No. pages: 02 mapl
Njësia Org.
Org. Jedin.
Org. Unit: 1698/2022
Nr. Prot.
Br. Prot.
Prot. No.: 10.08.2022
Data
Datum
Date: 10.08.2022
Dallëse PRISHTINË/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Ramiz Lladrovci , Kryetari i Komunës së Drenasit
	Milaim Hajdari , Kryesues i Kuvendit të Komunës
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Venera Çerkini , Zv. Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Resul Makreshi , Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Enis Spahiu , Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Klit Shala , Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	Bora Duli , Zytare e Lartë, Ligjore Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve Kimete Zekaj , Zytare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Drenasit
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuari Kryetar z. Lladrovci,

I nderuari Kryesues z. Hajdari,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 Për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

Vendimin nr.02-400/04-38621 për ndarjen e mjeteve
<i>I miratuar më datë 27.07.2022</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 28.07.2022</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 29.07.2022</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "**Ministria**"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Drenasit, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Drenasit, me anë të aktit administrativ që është subjekt i shqyrtimit, synon ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 8,000.00 euro për Marrëveshjen e Partneritetit të nënshkruar në mes të Komunës së Drenasit dhe ASB (Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland e.V.).
2. Si pikë e parë, edhe përkundër faktit se Komunave iu jepet pavarësi financiare në menaxhimin e financave të tyre, ashtu të precizuara me nenin 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Komunitat obligohen t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "**LMFPP**"), gjatë disponimit me të hyrat financiare komunale, e përcaktuar si në vijim:

Neni 7
Burimet Financiare Komunale

7.2 Komunitat duhet t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të LMFPP gjatë disponimit me këto burime financiare.



3. Në kuptim të shpenzimit të rregullt të parashë publike, neni 17 i LMFPP-së precizon qartë se paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike, si dhe të shpenzohen nga fondet e ndara dhe të alokuara [theks i shtuar].

4. Nisur mbi këtë bazë, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, si dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë për buxhetin e Komunës së Drenasit, ku është evidentuar se organizata buxhetore i ka të planifikuara shpenzimet e potencuara me aktin komunal për këtë vit fiskal.
5. Si përfundim, dhe duke marrë për bazë konstatimet e mësipërme, akti administrativ i Komunës së Drenasit është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve
Kopje:	Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës së Glogocit Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Venera Çerkini, Zv. Sekretarë e Përgjithshme në MAPL
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit të Ligjor dhe Monitorim të Komunave Data: 29.07.2022 Nr.020-654
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	Kujtim Aliu, Zyrtar i Lartë Ligjor
Lëndat:	Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glogocit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar, Vendimin nr. 02-400/04-38621 për ndarjen e mejteve i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale,

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin nr. 02-400/04-38621 për ndarjen e mejteve.

I miratuar më datë: 27.07.2022.

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 28.07.2022.



Republika e Kosovës
Kosova e Kosovës
Kuvendi i Kosovës



...di. ... 7/10

...di. ... 7/10 ...
...di. ... 7/10 ...
...di. ... 7/10 ...

...di. ... 7/10

Artikulli 1

...di. ... 7/10 ...
...di. ... 7/10 ...
...di. ... 7/10 ...

Artikulli 2

...di. ... 7/10 ...
...di. ... 7/10 ...
...di. ... 7/10 ...

Artikulli 3

...di. ... 7/10 ...
...di. ... 7/10 ...
...di. ... 7/10 ...

Artikulli 4

...di. ... 7/10 ...
...di. ... 7/10 ...
...di. ... 7/10 ...

Artikulli 5

...di. ... 7/10 ...
...di. ... 7/10 ...
...di. ... 7/10 ...

...di. ... 7/10 ...
...di. ... 7/10 ...
...di. ... 7/10 ...



...di. ... 7/10 ...
...di. ... 7/10 ...
...di. ... 7/10 ...

Arsyetim

Me marrjen e këtij vendimi do të përfitojnë 10 nga 30 familje të përzgjedhura nga ASB (Organizatë Ndërkombëtare Humanitare), të komunës së Drenasit, të cilat janë në asistencë sociale ku do ju krijohen mundësitë për fillimin e bizneseve të vogla familjare mbështetëse. Po ashtu në këtë marrëveshje përfshihet dhe subvencionimi i OJQ HandiKos duke renovuar dhe mobiluar zyret e saj. Shuma totale e kësaj Marrëveshje Partneriteti do të jetë 35.000.00€, ku ASB (Arbeiter-Samariter-Bund) do të co-financoj në këtë MP me shumën prej 27.000.00€, ndërsa Komuna e Drenasit do të co-financoj me shumën 8.000.00€. Ky projekt është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme Gjermane dhe implementohet nga Organizata Ndërkombëtare Humanitare Gjermane "Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland" ASB në Kosovë dhe Komuna e Drenasit.

Me respekt!